



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MALESI E MADHE
KËSHILLI

Nr. 2528/6 /Prot.

Koplik, më 2 /12 /2025

V E N D I M

Nr. 46, date 11.12.2025

Për

Miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës Financiare për familjen e Zotit Nuri Beqir Delaj banesa e te cilit është djegur nga zjarri

Këshilli i Bashkisë Malësi e Madhe ne mbledhje e datës 11.12.2025 me propozim të kryetarit të Bashkisë, mbështetur ne Ligjin 139/2015“Per vetëqeverisjen vendore“, neni 54, shkronja“dh“,Ligjin 45 neni 30,41 pika 1,2,3, datë18.07.2019“Per Emërgjencat Civile“, VKM_së nr.329 date 16.05.2012 kreu III/I “Per kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësi natyrore ose fatëkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“,Udhëzimi i perbashkët i Ministrisë së Brendëshme dhe Ministrës së Financave Nr.263,datë 224.05.2013 „Për kriteret dhe procedurat dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësi natyrore ose fatëkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“, VKB Nr.81..date 31.12.2024 Per miratimin e buxhetit të Vitit 2025.

V E N D O S I:

1-Të miratojë kërkesën e Bashkisë Malësi e Madhe per ndihmen e menjëherëshme financiare familjes së z. **Nuri Beqir Delaj**_në vlerën 500.000(peseqindëmijë) lekë, për djegjen e banesës së tij nga zjarri.

2-Burimi i financimit të jetë fondi i Emergjencave Civile parashikuar në Programin“**Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile**“, ne buxhetin e Bashkisë Malësi e Madhë per **vitin 2025** te miratuar me VKB. .81..date 31.12.2024 në programin_“Perballimi i ndihmave të menjëhershne për familjet në raste fatkeqesie“.

3-Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjorë të hartuar nga Bashkia Malësi e Madhe per familjen e z. **Nuri Beqir Delaj**_në vlerën e dëmit nga ana ndertimore ne shumen **4.801.179**(katër milionë e tetëqind e një mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë..) lekë, 50% i saj eshte **2.400.589,5** (dy milionë e katërqind mijë e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë, presje pesë.) lekë,si dhe vlera e demit ne paisje eshte **301.800** (treqind e një mijë e tetëqind.) leke ku 50% i saj eshte **150.900** (njëqind e pesëdhjetë

mijë e nëntëqind) lekë. Sipas preventivave të Komisionit të Vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Malësi e Madhe. Vlera totale e dëmeve është **5.103.079** (pesë milionë e njëqind e tre mijë e shtatëdhjetë e nëntë.) lekë ku 50% i saj është **2.551.539,5** (dy milionë e pesëqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e tridhjetë e nëntë, presje pesë.) lekë.

4- Ngarkohet administrata e bashkisë Malësi e Madhe për likuidimin e shumës prej **500.000** (peseqindë mijë) lekë.

5. Pjesa tjetër e vlers do të planifikohet për likuidim në buxhetin e vitit 2026 është 2.051.539,5 (dy milion e pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e tridhjetë e nëntë presje pesë lekë) si pasojë e fondeve të pa mjaftueshme për kompensim

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Finances dhe sektori i Emergjencave Civile.

7. Ky vendim hyne në fuqi sipas nenit 55, pika 6 e ligjit Nr.139/2015 „ Për veteqeverisjen vendore“

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miraturar me 11.12.2025

Vota Pro 19

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me date 12.12.2025

